

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPSTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TE KOMUNES/SAARBNET PREDSEDIKA OPSTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 382 Nr. i faq./Br.str./No.pg 133
Data/Datum/Date 3/4/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

KOMUNA RAHOVEC

**BULETINI MUJOR KOMUNAL
MARS 2023**



PËRMBAJTJA

HYRJE.....	2
AKTIVITETE TË KRYETARIT DHE TË DREJTORËVE TË DREJTORIVE.....	3
PËRFUNDIM	144

HYRJE

Ky buletin është krijuar me idenë e promovimit të aktiviteteve të Kryetarit të Komunës dhe të drejtorëve të drejtorive gjatë muajve të vitit 2023.

Rrëndësia e botimit të buletinit mujor qëndron në dhënien e mundësisë për informacionet mbi vendimet, zbatimin e politikave dhe rezultatet e aktiviteteve të Komunës së Rahovecit, në mënyrë të tillë që t'i mundësojmë qytetarit të ndjekë dhe të kontribuojë në mënyrë efektive në punën e institucioneve lokale.

Muaji mars i vitit 2023, është karakterizuar me një sërë aktiviteteve të Kryetarit dhe të drejtorëve të drejtorive.


Me anë të këtij buletini mujor për muajin mars, ne jemi munduar të paraqesim me fotografi dhe në detaje aktivitetet e Kryetarit të Komunës dhe të drejtorëve të drejtorive, në Komunën e Rahovecit.

AKTIVITETE TË KRYETARIT DHE DREJTORËVE TË DREJTORIVE



Në 50-vjetorin e themelimit, në shtëpinë e Bahtir Hajrizit, aty ku u themelua organizata e Grupit Revolucionar të Kosovës (GRK), nën përkujdesin e Shoqërisë "Lëvizja", u zbulua pllaka përkujtimore si një shenjë e kujtesës sonë historike dhe nder e mirënjohje për familjen e madhe Hajrizi, e cila dha qëndrestarë e luftëtarë të guximshëm që janë thesar i madh i Lëvizjes Kombëtare Çlirimtare të Kosovës dhe lanë gjurmë të pashlyera në rrugën e lirisë së atdheut.

Kryetari Latifi, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, vizituan Prekazin, në nderim të 25 - vjetorit të qëndresës dhe të flijimit të kryetrimit Adem Jashari dhe Familjes Jashari. Kjo shënoi edhe fillimin e pandalshëm të kthesës së madhe, e cila ndërroi kahun e rrjedhave të historisë për shqiptarët.



Në frymën e nderimit dhe të përkujtimit të 25-vjetorit të Epopesë së UÇK-së, Kryetari Latifi, së bashku me përfaqësuesit e OVL-UÇK-së, në Krushë të Madhe zbuluan 5 pllakat përkujtimore në shtëpitë e Nazmi Hotit, Rasim Zenunit, Jakup Hotit, vëllezërve Selmani dhe Qerim Selmanit, ku përmes tyre përkujtohet përkrahja dhe kontributi i këtyre familjeve në luftën e UÇK-së dhe ruhet kujtesa jonë kolektive dhe historike.

Me rastin e 7 Marsit - Ditës së Mësuesit dhe ditës së hapjes së Shkollës së Parë Shqipe, i shoqëruar nga drejtori i arsimit dhe nënkryetari i komunës, Kryetari Latifi vizitoi mësimmshënësit e 2 shkollave të komunës sonë, atë të Shfmu "Isa Boletini" në Rahovec dhe Shfmu "Heronjtë e Kosovës" në Hoçë e Vogël - Brestoc, me ç'rast ju uroi ditëlindjen e Shkollës së Parë Shqipe dhe Ditën e Mësuesit, si njëra nga ditët më të shenjta të historisë sonë kombëtare.



Së bashku me drejtorin e Bujqësisë Berat Durakun, Fatmir Selimin, Yllka Lamaxhema, Aida Selimin dhe Veli Hotin- përfaqësues nga Korporata Ndërkombëtare Financiare, pjesë e Bankës Botërore, në sallën e Kuvendit Komunal, është prezantuar Programi i Pagesave Direkte për vitin 2023, me theks të veçantë Sigurimi i Produkteve Bujqësore. Risi e këtij viti është se, sipas Udhëzimit Administrativ, pagesa e primit nga bujku, do të bëhet në vlerën 25% të shumës së përgjithshme. Përveç kësaj, Komuna e Rahovecit, ashtu sikurse vitin e kaluar, do të mbulojë edhe 15% shtesë të vlerës së përgjithshme.

Për nder të 8 MARSIT, Kryetari Latifi, mori pjesë në një tryezë të organizuar nga Grupi Joformal i grave asambleiste, tryezë e cila u përkrah nga Komuna e Rahovecit. Të gjitha nënave dhe bashkëshorteve të dëshmorëve të atdheut, motrave dhe grave shqiptare, u shprehu urimet më të mira për 8 MARSIN.





U MBAJT TAKIMI I RREGULLT ME PUNONJËSIT E ADMINISTRATËS KOMUNALE TË RAHOVECIT

Në sallën e Kuvendit Komunal, nën shoqërimin e nënkryetarit Iska, të drejtorit të administratës Besnik Hoti dhe të drejtorëve të drejtorive komunale, mbajti takimin e parë të rregullt periodik me punonjësit e administratës komunale. Gjatë takimit, kryetari theksoi edhe një herë rëndësinë e respektimit të orarit të punës dhe që punonjësit të kenë përkushtim të parrezervë në kryerjen e shërbimeve për qytetarë, duke ngritur gjithnjë e më shumë cilësinë e punës, për t'i bërë sa më të lehta dhe efikase shërbimet administrative.

RAHOVECI PO BËHET ME SHESH QENDROR

Në prani të bashkëpunëtorëve, të kompanisë ndërtuese si dhe të qytetarëve, Kryetari Latifi ka njoftuar se kanë filluar punimet në ndërtimin e Sheshit Qendror të Qytetit, projekt i cili do t'i japë pamje tjetër qytetit. Sheshi ka 3 hektarë sipërfaqe dhe do të përmbajë: Qendrën e sheshit - në formë rrethore; të përshtatshme për organizimin e ngjarjeve të mëdha dhe të aktiviteteve të ndryshme, treg ditor modern të mbyllur, parking nëntokësor me sipërfaqe 4850 m², që do t'i japë zgjidhje problemit të parkingjeve, parking mbitokësor, shteg të gjelbër, shteg për biçiklistë, shteg për këmbësorë, hapësira të gjelbra, lokale afariste. Vlera e projektit do të jetë 3,817,347.79 € dhe do të jetë investim nga Komuna e Rahovecit.



Në shënim të ditëlindjes së tij, në prani të familjarëve, miqve dhe bashkëpunëtorëve të tij, Kryetari Latifi mori pjesë në përurimin e Këndit të librit shkencor në bibliotekën komunale "Sulejman Krasniqi". Në raftet e këtij këndi janë sistemuar një mori veprash, shumë botime të profesorit Sabahajdin Cena, si dhe vëllime të shumta me përmbajtje shkencore. Besojmë se lexuesit do të vijnë të frekuentojnë sa më shpesh në këtë bibliotekë dhe të shfletojnë materialet e veshme që janë aty.

Nga z. Isa Elshani, kryetar i Asociacionit Kosovar për Energji të Ripërtëritshme dhe Eficiencë të Energjisë (AKEREE) dhe ekspertët e tjerë të këtij asociacioni, para Kryetarit të Komunës, z. Smajl Latifi dhe stafit të tij, kanë prezantuar studimin "Studimi për emisionet aktuale dhe masat që duhen marrë deri në vitin 2050, për t'i arritur objektivat për reduktimin e emetimeve të gazrave serrë – për Komunën e Rahovecit". Komuna e Rahovecit ka bërë hapa konkretë në fushën e efijencës së energjisë, duke planifikuar zona për investime në panele solare dhe të energjisë së erës, shkurtimet në shpenzimet e energjisë dhe instalimin e ndriçimit publik efijent.



Bashkë me nënkryetarin z. Fatmir Iska, drejtoreshën për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, znj. Saranda Sallteku dhe u.d. i drejtorit të QKMF-së "Dr. Fahredin Hoti", dr. Elbunit Kryeziu, kryetari Latifi, ka mbajtur takimin e parë për këtë vit me punonjësit shëndetësorë, me të cilët u diskutua për kapacitetet shëndetësore, shërbimet e ofruara dhe kushtet e punës në këtë institucion, furnizimet me pajisje dhe barna esenciale, kontrollën sistematike të nxënësve në shkolla, ofrimin e shërbimeve mobile, investimet që po bëhen në objektin e vjetër të QKMF - së, investimet që do të bëhen në rrjetin e AMF-ve dhe planet tona për të ardhmen.

Së bashku me bashkëpunëtorë dhe në praninë e z. Enrique Botero – USAID KMI, Drejtor i projektit, Kryetari Latifi, mori pjesë në punëtorinë e organizuar nga USAID-i, ku u prezantua Plani dhe Rezultatet e Gradimit të Komunës së Rahovecit, si pjesë e memorandumit të mirëkuptimit për Integritetin e Komunave të Kosovës. Komuna e Rahovecit, në bashkëpunim me këshilltarët e USAID-it, ka shënuar ngritje në kontrollin e brendshëm, prokurimin publik, menaxhimin e financave publike dhe në tregues të tjerë të gradimit 2021, si dhe rezultate për vitin 2022, si në vijim: Treguesi i indeksit të Buxhetit, treguesi i indeksit të Prokurimit, treguesi i indeksit të Menaxhimit të Projekteve të Buxhetit, treguesi i indeksit të Menaxhimit të Projekteve, treguesi i indeksit të ZKA-së, treguesi i indeksit të Auditimit të Brendshëm, treguesi i indeksit të Transparencës, treguesi i indeksit të Perceptimit të kënaqshmërisë qytetare, treguesi i indeksit të efektivitetit të prokurimit dhe të ndjeshmërisë ndaj korrupsionit.





Në zyrën e tij, Kryetari Latifi, ka pritur mësuesin Avni Koleci nga fshati Kishaj i Hasit, vëlla i dëshmorit Dinë Koleci, i rënë në krye të detyrës në bjeshkën e Pashtrikut, duke i prirë grupit të luftëtarëve të UÇK-së, të cilët po hynin në luftën çlirimtare me armatime dhe municione, më 2 qershor 1998, ku me këtë rast, atij i dhuroi emblemën e UÇK-së. Mirënjohës për angazhimin dhe rolin e madh dhe përkrahjen e pakursyer të vëllezërve dhe motrave tona, si dhe të familjeve nga tërë zona e Hasit, “përtej Drinit”!

Kryetari Smajl Latifi, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, nënkryetarin Fatmir Iska, drejtoreshën e DSHP-së, Saranda Sallteku dhe drejtorin e DSHP-së, Përparim Krasniqin, zhvilloi një takim joformal, por të nevojshëm dhe me shumë interes me Kryetarin e Suharekës, z. Bali Muharremaj. Zhvillimet e pandalshme pozitive dhe sukseset e tij të dukshme në Suharekë, paraqesin modelin më të mirë të një kryetari të përgjegjshëm, të angazhuar e punëtor dhe në shërbim të plotë të qytetarëve. Më pas, së bashku me Kryetarin Baliu, vizituan shtëpinë për të moshuar “Jetimët e Ballkanit” në Gjinoc, të cilët u pritën nga humanisti Halil Kastrati, i cili nga afër i njoftoi me ambientin e shtëpisë, kushtet e mira dhe hapësirat e përshtatshme për ofrimin e shërbimeve, organizimin e mirë dhe funksionalitetin, përkujdesjen dhe higjienën e nivelit shumë të lartë, që ofron kjo qendër me personelin e saj shumë profesional.



I shoqëruar nga drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport, z. Afrim Dina, Kryetari Latifi, ka nënshkruar kontratat me OJQ-të përfituese të subvencioneve nga fusha e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për vitin 2023. Përfituese nga thirrja e DKRS-së janë 23 OJQ nga 28 sa kanë aplikuar. Vlera e përgjithshme e mbështetjes financiare për këtë vit është 157.100€, përderisa në vitin 2022 ishte 121.750€.



Së bashku me Fadil Gashin, kryesues i Kuvendit Komunal të Klinës, familjarë të dëshmorëve e qytetarë, në fshatin Dush dhe Kramovik, në 77 vjetorin e rënies, janë përkujtuar luftëtarët e shquar për çlirimin dhe bashkimin e trojeve shqiptare, heronjtë e Besëlidhjes Shqiptare, si pjesë organike e LNDSH: Mustafë Ibishi, Xaj Pataqani, Malë Bashota, Halil Imeri, Jahë Kabashi, Feriz Gashi, Qazim Bajraktari dhe Halil Sadria. Më pas, në sallën e Kuvendit Komunal të Rahovecit, u mbajt akademi përkujtimore dhe në nderim të veprës atdhetare, familjeve të tyre, Kryetari I Komunës z. Smajl Latifi u ka ndarë mirënjohje me motivacionin "PËR KONTRIBUTIN E DHËNË PËR ÇLIRIMIN DHE BASHKIMIN E TROJEVE SHQIPTARE".



Në Shkup të Maqedonisë Veriore, së bashku me nënkryetarin e komunës z. Fatmir Iska, drejtorin e arsimit z. Avni Morina, drejtorin e QKMF-së z. Elbunit Kryeziu dhe me një pjesë të stafit të shëndetësisë, kryetari Latifi mori pjesë në punëtorinë e projektit ndërkombëtar "SOLICO" - Involvement and role of public authorities, civil society and volunteers in time of crisis as well as International SOLIdarity - learning from Corona pandemic. Në këtë punëtori, pjesëmarrës të së cilës ishin rrjetet e komunave të vendeve të ballkanit perëndimor, komuna jonë përfaqësoi Republikën e Kosovës. Temë bosht e punëtorisë ishte përfshirja dhe roli i institucioneve qeverisëse lokale në përballje me pandeminë Covid-19, pasojat e saj dhe mësimet e dala nga kjo pandemi.

Së bashku me bashkëpunëtorë dhe veteranë të UÇK-së, Kryetari i Komunës, z. Smajl Latifi, mori pjesë në hapjen e ekspozitës me fotografi, të fotografit të njohur, z. Asllan Krasniqi. Ekspozita me 24 fotografi, përkon me 24 - vjetorin e bombardimeve të NATO-s dhe të çlirimit të vendit. Në këto imazhe, pasqyrohet rezistenca dhe vendosmëria heroike e rahovecasve për moslejimin e hyrjes së rusëve në Rahovec.





Kryetari Latifi, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, bënë nderimet e tyre para varreve të heronjve në Glllogjan të Deçanit, në 25-vjetorin e Epopesë së Dukagjinit, një prej ngjarjeve më frymëzuese të luftës për liri. Epopeja e Dukagjinit bëri kthesë të rëndësishme rrugën e lirisë, e cila betejë u bë frymëzim për aksionet e shumta që do t'i organizonte UÇK-ja kundër forcave serbe gjithandej Kosovës. Fitorja e trimave të Dukagjinit jehonte përmes këngëve kudo ku gjëmonte pushka e UÇK-së. Rezistenca dhe qëndresa e Haradinajve me shokë, në atë 24 mars, dëshmoi se lufta për liri do të mposhtë çfarëdo force ushtarake.

Në nderim të 24 vjetorit të rënies, kryetari Latifi, bëri homazhe në Brestoc, i cili vendbanim nuk ka vetëm numrin e madh të të martirizuarve, por nga ky fshat kanë dalë shumë luftëtarë e veprimtarë, të cilët e kanë nderuar emrin e tyre dhe të vendlindjes. Po ashtu, në fushë të nderit kanë rënë shumë dëshmorë, lavdia e të cilëve qëndron si fllad pranveror mbi këtë vend.



24 vjet më parë, me 25 mars 1999, fshatrat Celinë dhe Fortesë u sulmuan barbarisht nga egërsirat pushtuese serbe, ku vranë fëmijë, gra, pleq e burra, përmes një aksioni të organizuar kundër shqiptarëve. Bashkë me familjarë të të rënëve, të mbijetuar e përfaqësues të OVL-së, në nderim të jetës dhe veprës së tyre, bëmë homazhe, nderuam e përkujtuam të gjithë dëshmorët e martirët që u sakrifikuan për lirinë e vendit.





Bashkë me familjarë, miq e veteranë të UÇK-së, në përvjetorin e rënies së tyre, mes fshatrave Krushë e Madhe, Nagac e Qëndresë (Randobravë), kryetari Latifi, nderoi kujtimin për dëshmorët e kombit: Ragip Hoti (vëllai i Ukshin Hotit), Xhemajli e Shukri Hoti, Sami Nalli, Agim Nalli, Agim Hoti dhe Njazi Gashi.

Më 26 mars 1999, në Krushë të Madhe, ndodhi masakra që do ta trondiste botën e civilizuar. Egërsirat serbe vranë e masakruan 241 fëmijë, gra, pleq e burra të paarmatosur. 24 vjet më parë, 64 shqiptarë të Krushës mbeten ende të zhdukur dhe nuk dihet asgjë për fatin e tyre. Në të njëjtën ditë, u vranë e u masakruan edhe 113 fëmijë, të rinj, burra dhe gra në fshatin Krushë e Vogël, ku 60 prej tyre edhe pas 24 vjetësh, ende nuk dihet ku janë e vazhdojnë t'i kenë varret e zbrazëta. Ky është gjenocid mbi popullatën shqiptare, për të cilin shteti serb duhet të dënohet sipas ligjeve ndërkombëtare.



Bashkë me familjarë e bashkëluftëtarë, në 24-vjetorin e rënies në vijën e parë të luftës, kryetari Latifi, bëri homazhe në vendlëniën e dëshmorëve të kombit, Enver Duraku (u plagos rëndë me 28 mars dhe mbylli sytë me 3 prill, në spitalin ushtarak të Pagarushës) nga Krusha e Madhe dhe Shefki Thaçi nga Rogova e Hasit.

Në 24 - vjetorin e përjetësimit të dëshmorit të kombit Sabit Shabandula nga Rahoveci, së bashku me familjarët, përfaqësuesit e organizatave të dala nga lufta e UÇK-së, familjarë të dëshmorëve, bashkëpunëtorë, kryetari Latifi, bëri homazhe dhe vendosi buçeta lulesh në varrezat e dëshmorëve të kombit në Rahovec.



Kryetari Latifi, së bashku me bashkëpunëtorë, në 24 - vjetorin e betejës së përgjakshme afër Shishmanit të Bokës, nderuan kujtimin për heroizmin e 14 dëshmorëve të atdheut. Më 29 mars 1999, u përjetësuan: Naim Avdiu, Florim Sejda, Besim Rama, Xhemajl Avdullahu, Bujar Sylja, Armend Qymyri, Ibrahim Asllani, Mon Maqi, Kadri Berisha, Nuhi Elezaj, Jashar Jashari, Bujar Shala, Mehdi Zabeli si dhe Jahja Danuza nga Rahoveci.

Së bashku me drejtorin ekzekutiv të organizatës "Teach for Kosova" z. Egzon Gashi dhe në prani të koordinatores së kësaj organizate, znj. Valmira Morina, si dhe drejtorit të arsimit, nënshkruam një marrëveshje mirëkuptimi. Me anë të kësaj marrëveshjeje, Komuna e Rahovecit do të bashkëpunojë me organizatën "Teach for Kosova" në shumë aspekte që lidhen me rritjen e cilësisë në arsim, në realizimin e trajnimeve të ndryshme dhe në realizimin e projekteve të ndryshme me nxënës të shkollave të mesme. Kjo marrëveshje mirëkuptimi do të fillojë së zbatuari në qershor të këtij viti dhe do të vlejë deri në qershor të vitit 2025.





NË RETIJË PËRKUJTOHEN DËSHMORËT DHE MARTIRËT E LIRISË, NË 24 - VJETORIN E PËRJETËSIMIT

Me familjarë, bashkëlufëtare, bashkëpunëtorë dhe përfaqësues të OVL-së, kemi përkujtuar dëshmorët dhe martirët e lirisë, në një fshat të vogël dhe me shpirt të madh e të paepur për liri, në fshatin historik të UÇK-së, në Retijë. Dëshmorët Bujar Thaçi, Ramadan Mazreku dhe Avni Thaçi dhe 17 martirë të vrarë nga pushtuesi serb, në mesin e të cilëve janë dhe 2 të zhdukurit nga ky fshat, i kujtuam me përlulje e nderim, për sakrificën e tyre për liri!

Kryetari Latifi, në prani të familjarëve, të bashkëlufëtareve, të bashkëpunëtorëve dhe të përfaqësuesëve të OVL-së, me përlulje përkujtuam dëshmorët dhe martirët e lirisë nga Opterusha. Gjaku i të rënëve u bë themel i lirisë së Kosovës dhe na bën dritë për të ecur pandalshëm drejt përparimit dhe forcimit tonë si popull dhe si shtet. Duke nderuar kujtimin për të rënë, nderojmë sakrificat e mëdha të këtij populli që aq shumë e dëshirojnë lirinë, duke dhënë gjërat më të shtrenjta.



Komunal.

ËSHTË MBAJTUR MBLEDHJA E RREGULLT E KUVENDIT KOMUNAL TË RAHOVECIT, E TRETË PËR KËTË VIT KALENDARIK.

Udhëhequr nga Kryesuesi - Defrim Kafexhiu, u mbajt seanca e tretë e rregullt për vitin 2023.

Mbledhja filloi me një minut heshtje në nderim të dëshmorëve dhe të martirëve të lirisë, në 24 - vjetorin e përjetësimit. Të pranishëm në seancë përveç kuvendarëve, si zakonisht, ishin edhe Kryetari i Komunës, Smajl Latifi, Nënkryetari Iska, drejtorët e drejtorive komunale, mediat që monitorojnë seancën dhe përfaqësuesit e KFOR-it dhe përfaqësuesit e organizatës japoneze "JICA". Rendi i ditës kishte 12 pika, të cilat kaluan me sukses edhe në këtë seancë të Kuvendit

Shefi i Kabinetit, z. Ali Morina, bashkë me drejtorin e Shërbimeve Publike, z. Përparim Krasniqi dhe zyrtaren për efikasitet, znj. Diellza Çanta, pritën në takim përfaqësues të KFOR-it dhe të LMT-së. Në këtë takim u diskutua për mundësinë e investimit nga ana e KFOR-it në projekte të vogla në fushën e energjisë së ripërtëritshme dhe të shëndetësisë. Ne do të jemi të hapur për bashkëpunim dhe do t'i adresojmë kërkesat tona në këto fusha.



Nënkryetari i Komunës së Rahovecit, z. Fatmir Iska, bashkë me drejtorin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Afrim Dina dhe shefin e kabinetit, z. Ali Morina, pritën në takim trajnerin e shkollës së basketbollit "Halit Hoxha", z. Admir Mullabazi dhe pionierët e kësaj shkolle, të cilët fituan Kupën e Kosovës, në kategorinë U-12. I uruan për suksesin e arritur dhe i inkurajuan që të vazhdojnë edhe me suksese të tjera. Përkrahja për këta çuna nuk ka munguar asnjëherë dhe nuk do të mungojë as në të ardhmen.

24 VJET NGA MASAKRA E PASTASELIT

Në ditën e fundit të marsit të përgjakur të vitit 1999, ndodhi një prej krimeve më mizore të kriminelëve serbë dhe të shtetit terrorist të tyre, në fshatin Pastasel të Rahovecit, të cilët vranë, masakruan, dogjën e zhdukën 106 fëmijë, gra, pleq e burra të paarmatosur. Pastaseli ia fali luftës sonë çlirimtare bashkëluftëtarët Milaim Krasniqi dhe Fadil Krasniqi, të cilët ranë me pushkë në dorë në altarin e lirisë, gjë që dëshmuar vlerat morale të trashëguara nga të parët.



PËRFUNDIM

Ky buletin përmbledhës paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë muajit mars 2023.

Fusha e qeverisjes së mirë është mjaft e gjerë, e një aspekt i rëndësishëm i saj, që është i pashmangshëm për ta plasuar qytetarin në vend qendror, është liria e informimit.

Informacioni është themeli i qeverisjes së mirë, jo vetëm sepse e rrit efikasitetin, porse i fuqizon qytetarët dhe mundëson shpërndarje të barabartë të përfitimeve nga zhvillimi i përgjithshëm në vend, andaj duke dashur që të jetë sa më transparente me publikun, Komuna e Rahovecit, përmes këtij buletini mujor, ka ofruar një pasqyrë të përgjithshme të aktiviteteve të saj, për t'u dhënë mundësi qytetarëve që ta njohin dhe ta vlerësojnë punën e institucioneve komunale.

Komuna e Rahovecit ka vënë në funksion këto parime, përmes formave të ndryshme të komunikimit me qytetarë, të takimeve të drejtpërdrejta, të informimit publik dhe të çfarëdo metode tjetër, përmes së cilës transparenca të ndikojë në avancimin e vetëqeverisjes lokale.

Përveç konsultimit dhe komunikimit, këto dokumente forcojnë lidhjet e qytetarëve me komunën dhe rrisin besimin që e gëzojnë zyrtarët publikë në nivel lokal.

Rahovec, mars 2023